



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
KËSHILLI BASHKIAK
Komisioni i Përhershëm për Punën dhe Çështjet Sociale
RAPORT VENDIMMARRJE
Nr. 4 datë 24.03. 2026

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit nr. 1 datë 13/02/2026, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin për "Miratimin e dhënies së ndihmës ekonomike, duke përdorur 6% të fondit total të ndihmës ekonomike të muajit Janar 2026"

Analiza ligjore: Projekt vendimi është në zbatim të ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", Ligji nr 57/2019, date 18.07.2019 "Per Asistences Sociale ne Republiken e Shqiperise", VKM Nr. 597, datë 04.09.2019, "Për përcaktimin e procedurave të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmes ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike"; Mbi zbatimin e vendimit Nr. 597, date 04.09.2019, "Për përcaktimin e procedurave të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të Ndhimes Ekonomike"; Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 02, datë 09.02.2024, Për miratimin e kriterëve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike duke përdorur deri në masën 6% të fondit të ndihmës ekonomike" VKM nr.8 dt.14.01.2015 "Per mbrojtjen e shtesave ne nevoje per efekt te heqjes se fashos se konsumit te energjise elektrike deri ne 300 Kwh ne muaj".

Situata aktuale dhe financiare e funksionit:

Sektori i Ndhimes Ekonomike dhe Shërbimit Social pas verifikimeve të kryera në familje dhe përlllogaritjes së fondit 6% të ndihmës ekonomike rekomandoi miratimin e dhënies së ndihmës ekonomike duke përdorur 6% të fondit të ndihmes ekonomike të muajit Janar 2026 me fond total 1.588.352 lekë. Fondi i 6% që do të përdoret është 94.991 lekë, me të cilin përfitojnë 28 familje.

Drejtorja / Sektori përgjegjës:

Drejtorja e Çështjeve Sociale ka relatuar përpara komisionit për Projekt vendimin

Monitorimi dhe raportimi : Komisioni për punën dhe çështjet sociale dhe të gjithë këshilltarët do të monitorojnë zbatimin e buxhetit dhe do të thërrasin sa herë të jetë nevojshme Drejtorinë Çështjeve Sociale.

Impakti social / grupet që preken: Projekti impakton jetën e të gjitha shtresave, kategorive të varfra në të gjithë territorin e Bashkisë Pukë

A është objekt i konsultimit publik: Nuk është objekt konsultimi me publikun Komisioni për Shërbime Publike dhe Prona, i mbledhur me datën 24/03/2026, shqyrtoi projekt vendimit nr.1 datë 13/02/2026, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin për "Miratimin e dhënies së ndihmës ekonomike, duke përdorur 6% të fondit total të ndihmës ekonomike të muajit Janar 2026" paraqitur nga Kryetari i Bashkisë.

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,

Komisioni me shumicë votash,

VENDOSI

1. T'i propozojë Këshillit Bashkiak:
 - a) kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim
 - b) miratimin e projektaktit

Dritan Asani Duf
(emri, mbiemri, firma)

Kryetar i Komisionit

Sekretar i Komisionit

ALFONS GJERGJAJ 

Datë 24.03.2026

Sekretari i Këshillit
H. T. Duf
